

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Gjakova – Raporti komunal

Nëntor 2009

Gjakova në shifra

Popullsia	Gjithsej	119590
	Shqiptarë	92.9%
	Romë	7.1%
	Të tjerë	0.05%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	521
	Numri i fshatrave	84
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	14.91%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	37.36%
	E mesme	37.93%
	Shkollë e lartë	8.38%
	Universitet	1.42%
	Nr. i nxënësve	24848
	Nr. i mësimdhënësve	1272
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	10
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	51
	Nr. i çerdheve	7
	Shëndetësia	Spital
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare		1
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		26
Nr. i mjekëve		92
Papunësia	Gjithsej	42.26%
	Meshkuj	39.64%
	Femra	49.06%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	72,950
	Të punësuar në sektorin publik komunal	2,207
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	12,244,283
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	1,622,000
	Të hyrat tjera (Euro)	10,622,283
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	10,436,203 (92%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	2,020,793 (75%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	8,415,410 (97.6%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	AAK	23.91%
	LDK	18.47%
	AKR	14.08%
	ORA	10.04%
	PSHDK	7.96%
	LDD	7.28%
	PDK	6.20%
	PDKI	3.58%
	Alternativa për Gjakovën	3.10%
	IRDK	2.43%
	LKÇK	1.22%
	Të tjerë	1.73%

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Gjakovën

Komuna e Gjakovës është komuna me numrin më të madh të fshatrave në Kosovë, me 84 fshatra sa ka kjo komunë radhitet e para për nga kjo statistikë. Ka një territor prej gjithsejtë 521 km² dhe për nga gjerësia e territorit radhitet e shtata. Në këtë komunë jetojnë rreth 120,000 banorë dhe për nga numri i popullsisë Gjakova radhitet e gjashta në Kosovë. Dikur një qendër e zhvilluar ekonomikisht dhe me shumë ndërmarrje shoqërore, tani Gjakova po përballet me një numër të lartë të papunësisë dhe ngecje në zhvillim ekonomik. Gjakova për pjesën tjetër të Kosovës është e njohur për teatrin e saj profesional dhe muzikën e saj unike. Është një nga qytetet e pakta të Kosovës që ka arrit të ruaj ende pjesët e vjetra të qytetit. Çarshia e vjetër, edhe pse e shkatërruar në masë të madhe në luftën e fundit, ajo sërish ka arrit të rimëkëmbet.

Problemet aktuale

Gjakova përballet me probleme të shumta, siç janë papunësia, varfëria zhvillimi i ulët ekonomik, etj. – probleme që mund të gjenden edhe në komunat tjera pa dallim. Në këtë komunë janë të përqendruara një numër i madh i ndërmarrjeve publike. Këto ndërmarrje ende nuk janë privatizuar të gjitha dhe komuna e Gjakovës është një nga komunat ku privatizimi ka ngecur më së shumti. Kjo për arsye se shumica e ndërmarrjeve publike nuk e kanë statusin e definuar qartë. Në Qendrën Komunale të Punësimit në Gjakovë janë të regjistruar 18,543 të papunë. Ky numër i të papunëve të regjistruar përbën 15.5% të popullsisë së Gjakovës. Por kjo shifër nuk paraqet gjendjen reale të papunësisë, ngase konsiderohet se 42.2% e popullsisë së aftë për punë janë të papunë. 1,380 familje me 6,308 anëtarë janë të varur nga ndihmat sociale (5.2% e popullsisë). Përveç këtyre problemeve, probleme tjera në Gjakovë janë edhe:

- Mbeturinat dhe higjiena publike,
- Mungesa e ujit;
- Moskujdesi ndaj pjesës së vjetër të qytetit,
- Ndërtimet ilegale.

Mbeturinat. Gjatë viteve të fundit, në komunën e Gjakovës është investuar në gjelbërim të hapësirave dhe largim të objekteve të përkohshme nga qyteti. Mirëpo, nuk është bërë mjaft në mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese. Për këtë arsye, qytetarët shumë pak qëndrojnë në këto hapësira. Gjendje edhe më e rëndë është nëpër fshatra. Nëpër lokalitetet e komunës mund të hasen me dhjetëra deponi të egra mbeturinash. Nga djegia e mbeturinave në deponinë e bërllokut në “Koloni” kundërmon i tërë qyteti. Mbeturina hasen edhe në pjesën e vjetër të qytetit. Lumi Erenik është i papastër dhe në të hidhen mbeturina, ujërat e zeza e edhe kafshë të ngordhura. E njëjta gjendje është edhe në Liqenin e Radoniqit. Nga ky liqen furnizohet me ujë e tërë komuna dhe më gjerë, si dhe është i vizituar nga shumë qytetarë të cilët ditëve të verës preferojnë të kalojnë kohën në këtë pjesë. Mirëpo, përreth liqenit hasen shumë mbeturina që janë lënë nga vizitorët e që nuk janë larguar nga shërbimet e komunës. Përveç deponive të bërllokut, në Gjakovë hasen

edhe shumë deponi të hekurishteve, të cilat i japin një pamje jo të mirë qytetit dhe ndikojnë në ndotjen e tokës.

Mungesa e ujit të pijes. Komuna e Gjakovës, në krahasim me komunat tjera, nuk përballet me mungesë të ujit për pije. Nga liqeni i Radoniqit furnizohet pjesa më e madhe e komunës së Gjakovës dhe Rahovecit. Gjatë tri viteve të fundit, niveli i ujit në liqenin e Radoniqit ka rënë dukshëm. Rënia e nivelit të ujit, ka bërë që uji të bart një shije të rëndë myshku dhe ky problem është vërejtur sidomos në verën e vitit 2008. Në humbjen e ujit të “Radoniqit” po ndikon edhe sistemi i ujitjes së tokave bujqësore “Dukagjini-Radoniqit”. Për një sezon ky sistem i ujitjes së tokave bujqësore shpenzoi 7 milionë kub ujë për ujitje, kurse vetë liqeni i “Radoniqit” ka vetëm 70 milion kub ujë. Për më tepër sistemi i ujitjes derdhi sasi të madhe të ujit në lumin Drini i Bardhë duke bërë që një sasi e madhe e ujit të harxhohet kot. Gjakova është komuna me numrin më të madh të fshatrave në Kosovë dhe infrastruktura nuk ka arritur në të gjithë fshatrat. Rrjeti i ujësjellësit mungon në fshatrat e Dushkajës dhe Rekës së Keçe.

Moskujdesi ndaj pjesës së vjetër të qytetit. Gjatë luftës së fundit, çarshia e vjetër e Gjakovës ishte djegur nga forcat serbe. Pas vitit 1999 pronarët e bizneseve kishin filluar rindërtimin e kësaj pjese, e cila për nga ndërtimi dhe vjetërsia është unike në Kosovë. Çarshia e vjetër është atraksion për turistët dhe vizitohet nga shumë qytetarë, por mungesa e mirëmbajtjes në këtë pjesë ka ndikuar që kjo pjesë e qytetit të humb rëndësinë e saj. Çarshia e vjetër nuk ka kujdesin e mjaftueshëm nga pushteti lokal dhe nuk ka arrit që të zhvillohet. Bizneset e vogla në këtë pjesë nuk janë të qëndrueshme. Mungon infrastruktura përcjellëse, nuk mirëmbahet, ka mbeturina të shumta, etj. Edhe pse pjesa më e madhe e shtëpive dhe bizneseve në këtë pjesë janë rindërtuar, ende ndodhet disa objekte që kanë mbetur gërmadha që nga lufta. Tani ato objekte shfrytëzohen si deponi të egra bërriloku. Komuna ka bërë disa herë pastrimin e kësaj pjese, mirëpo problemi vazhdon të shfaqet sërish pasi që qytetarët vazhdojnë të hedhin mbeturinat në të.

Gjendja jo e mirë urbanistike. Një nga problemet e komunës së Gjakovës është edhe gjendja jo e mirë në urbanizëm. Në Gjakovë janë identifikuar 228 objekte pa leje. Komuna ka filluar legalizimin e atyre që nuk bien ndesh me planin urbanistik të qytetit. Nga legalizimi i ndërtimeve komuna ka arrit që të arkëtoj më shumë të hyra gjatë këtyre dy viteve. Mirëpo, ky proces i legalizimeve ka bërë që shumë qytetarë të ankohen për mënyrën e legalizimit të tyre dhe ata shprehen se shumica e ndërtimeve të larta të ndërtuara pa leje, tani po legalizohen. Problem tjetër që shqetëson qytetarët e kësaj komune është edhe ndërtimi i pompës së benzinës në afërsi të objektit të shkollës “Mustafa Bakija” (afër teqesë së “Sheh Mahmutit”). Rrugët kryesore të qytetit të cilat janë shtruar rishtazi, paraqesin problem me rastin e reshjeve atmosferike. Rrugët “Nëna Terezë” dhe “Mark Malota”, pas çdo reshjeve mbushen me ujë pasi që kanalizimi atmosferik nuk mund të absorbojnë sasinë e reshjeve. Rrugët e disa fshatrave edhe më tutje mbetet të pa asfaltuara. Banorët e fshatit Kralan që nga paslufta presin nga pushteti lokal që të shtroj rrugën kryesore për këtë fshat, mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në dy mandatet e para qeverisëse, LDK me kryetarin Aqif Shehu kishin qeverisur shtatë vite me komunën. Në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, shumicën e votave e fitoi kandidati i AAK për kryetar komune Pal Lekaj. Në raundin e parë të zgjedhjeve Pal Lekaj fitoi 37.98% të votave. Të drejtën për garim të mëtutjeshëm në zgjedhjet e balotazhit e fitoi edhe kandidati i LDK për kryetar komune Astrit Haraçia. Tri javë më vonë, në ballotazh, Pal Lekaj përfundimisht fitoi të drejtën që të qeveris me komunën për mandat dy vjeçar. Në raundin e dytë ai fitoi 56.5% të votave.

Gjatë fushatës para zgjedhore, kryetari aktual premtoi shtrim të rrugëve, furnizim me ujë të pijes, rritje të të hyrave buxhetore, përmirësimi i ndriçimit publik, lobim në drejtim të privatizimit të ndërmarrjeve publike, shuarja e dallimeve fshat-qytet. Tabela nr.1 paraqet realizueshmërinë e premtimeve dy vite më vonë.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Për dy vite do të investohen 3,748,000 € në infrastrukturën rrugore;	Për dy vite komuna ka bërë shtrim të rrugëve me asfalt, riparim të rrugëve, mirëmbajtje gjatë dimrit, shtrim me zhavor dhe sinjalizim. Për projekte rrugore për këto dy vite janë ndarë 2,720,605 €, kurse 1,050,258 € kanë qenë të destinuara për bashkëfinansim me nivelin qendror, donatorët dhe komunitetin (mjettet e ndara për bashkëfinansim nuk janë shpenzuar vetëm në rrugë por edhe në projekte tjera kapitale).
Rritja e të hyrave komunale, sidomos nga tatimi në pronë;	Të hyrat vetanake në 2008 në krahasim me një vit më parë janë rritur për 120.8%. Edhe tatimi në pronë është rritur këtë vit. Në gjashtë mujorin e parë të 2009, të hyrat vetanake janë rritur për 14% në krahasim me të njëjtën periudhë të 2008.
Sigurimi i ujit të pijes nga Sistemi i Radoniqit për këto tri zona: Dushkajës, Rekës së Keqe dhe Hasit; këto do të kushtojnë 1,280,000 € dhe do të financohet nga komuna dhe donacionet e USAID, DFID dhe AER, ngase projekti është i gatshëm.	Projekti nuk është realizuar në tërësi. Përveç Hasit, në Dushkajë dhe Rekën të Keqe nuk është investuar asgjë.
Investime në përmirësimin e ndriçimit publik në qytet (për këtë do të ndahen 92,200 €) dhe nëpër fshatra (52,000 €);	Projekt i pëmbushur përgjysmë. Kryetari aktual ka investuar në ndriçimin publik, por vetëm në zonat e dukshme – qendrën e qytetit, ndërsa pjesët tjera janë ende të pandriçuara. Hyrjet daljet e qytetit në të gjitha anët kanë mungesë të ndriçimit publik, e gjithashtu edhe rruga pranë gjimnazit, e cila doemos duhet ndriçuar ngase është edhe vend ku shpesh ndodhin përleshje mes nxënësve. Investimet në fshatra ishin më të vogla se ato në qytet.
Lobim në Qeverinë qendrore që të privatizohen fabrikat publike të Gjakovës	Nuk ka asnjë ndryshim në këtë aspekt.
Heqja e dallimeve fshat-qytet.	Në komunën e Gjakovës, në mes të popullsisë

ekzistojnë paragjykime dhe ndarje në mes popullsisë që jeton në fshatra dhe atyre në qytet. Ky dallim është ngulitur në sjelljet e popullsisë për një periudhë të gjatë, por ka filluar të zbehet viteve të fundit. Zbehja e dallimeve ka ardhur si pasojë e ndryshimit të sjelljes dhe qëndrimeve të vetë popullatës, dhe jo si rezultat i angazhimit institucional.

Zgjedhjet lokale në Gjakovë

Në Kuvendin Komunal të Gjakovës mund të zënë vend 41 përfaqësues. Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme, 35 subjekte të ndryshme politike kanë garuar për të zënë vend në Kuvendin Komunal (KK). Por vetëm 13 prej subjekteve kanë mund që të arrijnë të përfaqësohen në KK. Nga këto 13 subjekte politike që kanë arrit të përfaqësohen në KK, vetëm katër prej tyre janë përfaqësuar vazhdimisht në tri mandatet, kurse partitë tjera kanë qenë prezent në KK vetëm për një mandat.

Në zgjedhjet e para lokale më 2000, LDK mori numrin më të madh të votave dhe me 26 ulëse siguroi shumicën në KK; AAK u radhit e dyta me 7 ulëse, PSHDK e treta, etj. Dy vite më vonë, në zgjedhjet lokale të 2002, LDK pësoi një rënie në vota dhe arriti të fitoj 9 ulëse më pak; AAK fitoi më shumë në vota dhe mori tri ulëse më shumë se sa dy vite më parë, kurse PDK mbajti numrin e njëjtë të ulëseve dhe me një rënie të lehtë në vota. Në zgjedhjet e treta lokale, rënia në vota e katër partive më të mëdha vazhdoi edhe më tutje, mirëpo përkundër kësaj AAK arriti që të mbaj numrin e njëjtë të ulëseve.

Në tri palë zgjedhjet lokale kanë konkurruar edhe tre kandidat të pavarur, por asnjëri prej tyre nuk ka mund të marr votat e nevojshme për përfaqësim. Në anën tjetër, iniciativat lokale kanë treguar sukses në zgjedhjet lokale. Në tri mandatet e gjertanishme dy iniciativa lokale kanë siguruar vend në KK. Në zgjedhjet e dyta lokale, Alternativa për Gjakovën fitoi një vend në KK, kurse në zgjedhjet e treta Unioni Demokratik i Gjakovës fitoi tri vende.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Gjakovës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	3010	3	2772	3	1889	3
LDK	24928	26	15540	17	5625	8
AAK	7031	7	9038	10	7285	10
PSHDK	3938	4	4909	5	2424	4
ORA	-	-	-	-	3059	4
LDD	-	-	-	-	2218	3
AKR	-	-	-	-	4289	6
Alternativa	-	-	-	-	944	1

për Gjakovën						
PDKI	-	-	-	-	1090	1
IRDK	-	-	1411	2	739	1
LKÇK	-	-	-	-	373	1
UDGj	-	-	2881	3	-	-
PLK	856	1	834	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 79.4%, dy vite më vonë ajo ra në 54.2%, kurse për vitin 2007 ra edhe më shumë në 39%. Përderisa në shumicën e komunave, zgjedhjet e balotazhit (që janë mbajt tri javë pas raundit të parë të votimeve) kanë shënuar një rënie edhe më të madhe të votuesve, në komunën e Gjakovës në zgjedhjet për balotazh kanë votuar 3,209 votues më shumë se në raundin e parë. Në zgjedhjet e nëntorit 2009, të drejtë vote kanë 91,883 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Gjakovë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	55529	72641	78086
Pjesëmarrja në votime	44090	39368	30463
Përqindja e daljes në votime	79.4%	54.20%	39%

Buxheti i Komunës

Buxheti i Komunës së Gjakovës kryesisht ka shkuar duke u rritur prej vitit në vit, me përjashtim të vitit 2007 kur nga 9 milion kishte rënë në 8.5 milion euro. Brenda gjashtë viteve buxheti i komunës së Gjakovës nuk ka shënuar një rritje të madhe. Përderisa në vitin 2003 kjo komunë kishte një buxhet prej 7,406,793 euro, në vitin 2009 ka 12,244,283 euro. Në fakt kjo është rritja më e madhe e buxhetit prej vitit në vit, ngase krahasuar me vitin 2008 kur buxheti ishte 9,392,780 euro, buxheti i komunës për vitin 2009 është rritur për 2,851,503 euro. Pjesa më e madhe e buxhetit të vitit 2009 është e destinuar për rroga dhe mëditje, kurse mbi 3 milion euro janë të destinuara për në investime kapitale.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€6,544,675	€1,351,085	€519,000	€200,000	€3,629,523	-	€12,244,283
2008	€5,485,765	€1,476,085	€601,800	€200,000	€1,629,130	-	€9,392,780
2007	€5,277,351	€1,270,708	€491,000	€238,000	€1,317,596	-	€8,594,655
2006	€5,299,057	€1,229,096	€666,150	€240,000	€1,614,494	-	€9,048,797
2005	€5,249,947	€1,010,981	€346,700	€165,000	€2,432,634	-	€9,205,262
2004	€5,092,542	€1,929,437	-	-	€2,078,527	€131,000	€9,231,506
2003	€3,841,626	€2,321,301	-	-	€1,148,806	€95,060	€7,406,793

Nga tabela e mësipërme mund të vërehet se kryesisht ka pas një rritje konstante në shpenzimet për rroga dhe mëditjet. Në vitin 2009 janë shpenzuar 6,544,675 euro, që është gati gjysma e buxhetit total. Krahasuar me vitin 2008, më 2009 për rroga dhe mëditje janë shpenzuar afër 1,058,910 euro më tepër.

Buxheti total i 2008, deri në fund të vitit është shpenzuar në masën 92%. Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Komunës së Gjakovës për 2010-2012, buxheti i përgjithshëm i kësaj komune për tri vitet në vazhdim do të jetë 57,410,523 €.

Investimet kapitale

Investimet kapitale për vitin 2009 janë më të lartat që janë arrit ndonjëherë. Nga buxheti i komunës për vitet 2008-2009 janë ndarë mbi 5 milion euro për investime kapitale. Këto mjete janë shpenzuar në disa projekte madhore ku ndër to përfshihen:

Tab.5.: Investimet kapitale në Gjakovë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve (€)
2008	Ndërtimi i Bibliotekës së qytetit	106,764
2008	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit	100,000
2008	Ndërtimi i rrugës së Haraqisë	100,000
2009	Ndërtimi i rrugës së Haraqisë	54,548
2009	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza	47,932
2009	Asfaltimi i rrugës A. Moisiu	520,408
2009	Asfaltimi i rrugës Blinish-Ramoc-Ahmat	152,000
2009	Asfaltimi i rrugës Rugovë-Dedaj	195,000
2009	Asfaltim i rrugës së fshatit Shishman i Bokës	225,000
2009	Asfaltimi i rrugës së fshatit Damjan – Lagjja e Shehut	83,805
2009	Asfaltimi i rrugës Firaj-Dobrixhe	84,971
2009	Asfaltimi i rrugës së fshatit Nec	150,000
2009	Asfaltimi i rrugës Ujz-Pnish	150,000
2009	Ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit	47,218

Buxhetin e ndarë për investime kapitale në vitin 2008, Komuna e Gjakovës ka arrit ta realizoj në masën 75%; kurse në periudhën janar-qershor 2009 buxheti për investime kapitale është realizuar 59.7%. Investimet kapitale në tri vitet e ardhshme janë paraparë të rriten edhe më tej. Kuvendi Komunal i Gjakovës veç ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Gjakovës do të ketë në dispozicion 17,434,303 € për investime kapitale, gjegjësisht 5,319,289 euro për 2010; 5,817,647 euro për 2011, dhe 6,297,367 për vitin 2012.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Gjakovë 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	14,335,018	15,147,751	15,683,471
Të hyrat vetanake në €	2,563,606	2,644,990	2,721,288
Investimet kapitale në €	5,319,289	5,817,647	6,297,367

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Gjakovës për mandatin e tij qeverisë katërvjeçar do të ketë në dispozicion pak më shumë se 23.7 milion € për investime kapitale.

Administrata komunale

Në sektorin publik në komunën e Gjakovës në vitin 2009 janë të punësuar 2,207 persona. Këta persona janë të punësuar në sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe administratës. Krahasuar me vitin 2008, sektori publik i kësaj komune është rritur për 7 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 750 banorë duhet të ketë një punëtorë administrativ, del se komuna e Gjakovës duhet të ketë 208 punëtorë administrativ. Momentalisht kjo komunë ka 209 shërbyes civil.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Gjakovës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	2207 ▲
2008	2200 ▲
2007	2197
2006	2220 ▲
2005	2211
2004	2267 ▲
2003	2096 ■

Komuna e Gjakovës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, e që duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK i Gjakovës gjatë vitit 2008 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK e Gjakovës ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, numër ky që është konform nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionalizuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 7 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, për vitin 2008 mungojnë të dhënat se sa tubime publike janë mbajtur në Komunën e Gjakovës, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 është mbajtur 1 tubim. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare komuna e Gjakovës gjatë vitit 2008 ka pranuar një kërkesë dhe vetëm një peticion.

Uebfaqja e Komunës së Gjakovës është e mirëmbajtur/azhurnuar në baza të rregullta kohore. Është e pajisur me informacione të mjaltshme, aq sa një qytetari të Gjakovës do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës. Por jo të gjitha kategoritë që figurojnë në uebsajt përmbajnë edhe informacione. Siç mund të vërehet edhe nga tabela e mëposhtme ueb faqja ka mungesa në fushat: shërbimet komunale, projektet komunale, si dhe në lajme & lajmërimet.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Gjakovës (www.gjakova-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	5
Organizimi komunal	3
Shërbimet komunale	2.2
Info rreth qytetit	4
Projektet komunale	2.25
Lajme& lajmërimet	2.33
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	5
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	3
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	3.48
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	6

Gjendja në arsim

Gjatë këtij mandati qeverisës në Komunën e Gjakovës është ndërtuar shkolla e muzikës, dhe 2 shkolla të tjera fillore, si dhe janë shtuar disa anekse. Megjithatë, ende ka shkolla ku mësimi mbahet në 3 ndërrime, siç është shkolla fillore “Mazllum Këpuska”. Përndryshe, arsimit në Komunën e Gjakovës zhvillohet nga niveli parashkollor deri te ai universitar. Gjakova ka fakultetin e edukimit, 10 shkolla të mesme dhe 51 shkolla fillore. Numri i nxënësve në këtë komunë është në rritje, dhe kjo ka pamundësuar menaxhimin e duhur të këtyre nxënësve (duhet theksuar se ka shumë nxënës që udhëtojnë prej Bajram Currit për t’u shkolluar në komunën e Gjakovës). Numri i nxënësve është 24,848, kurse numri i mësimdhënësve është 1,272, apo 1,3 punonjës të arsimit për 100 banorë. Megjithatë, një nga problemet evidente në arsim mbetet pasiguria e nxënësve pas përlëshjeve të shumta mes vete.

Gjendja në shëndetësi

Gjakova ka spitalin rajonal ku kryhen shërbimet primare dhe ato sekondare. Kjo komunë përveç QKMF ka edhe 10 QMF dhe punkte të tjera shëndetësore. Në nivelin

² Radhitja nga 1 deri 5: 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

primar punojnë 371 punëtorë shëndetësorë, apo 3.0 punonjës shëndetësor për 1,000 banorë. Në QKMF punojnë 33 specialistë të mjekësisë familjare, 22 mjek të përgjithshëm, 38 stomatologë të përgjithshëm dhe 142 infermier.

Sa i përket investimeve në shëndetësi, për dy vite i vetmi investim është bërë në blerjen e dy automjeteve për nevoja të shëndetësisë primare. Një nga problemet që hasin qytetarët kur përballen me institucionet shëndetësore është edhe pamundësia për të blerë barna pas orës 23.30. Nga 20 barnatoret private në komunën e Gjakovës, asnjëra prej tyre nuk punon pas orës 23.30 duke bërë që qytetarët që kanë nevojë për ndonjë ilaç urgjentisht u duhet që të presin deri në ora tetë në mëngjes ose të marrin rrugë për ndonjë komunë tjetër, ngase ilaçet nuk mund ti gjejnë as në QKMF apo spitalin regional në Gjakovë. Kryetari i komunës ka lëshuar një urdhëresë ku kërkon që barnatoret e qytetit të mbajnë kujdestari edhe gjatë orëve të vona të natës, mirëpo kjo urdhëresë e kryetarit nuk po respektohet ende.

Shoqëria civile

Komuna e Gjakovës ka 44 OJQ të regjistruara në Forumin e OJQ-ve "Gjakova" por jo të gjitha janë aktive. Shumë prej organizatave aktivizohen për 2-3 muaj sa zgjasin donacionet për projekte të cilat ato i fitojnë. Ndër organizatat më aktive është vetë Forumi i OJQ-ve e cila përpos koordinimit të OJQ-ve merret edhe me monitorimin e pushtetit lokal. Ky Forum së fundi ka organizuar edhe debate të ndryshme tek të rinjtë. Mjaft aktive është edhe Rrjeti "Qeliza" e cila është organizatë ombrellë e 6 organizatave joqeveritare për gra, të cilat merren me organizim të trajnimeve, debateve, madje edhe bëjnë mbështetjen e grave që punojnë punë-dore duke bërë plasmanin e këtyre produkteve në tregje të ndryshme. Ndër organizatat aktive është gjithashtu FDI - "Fondacioni për Iniciativë Demokratike", por e cila ka ndërruar lokacionin dhe është vendosur në Prishtinë. FDI-ja përpos tjerash merret edhe me çështjet e demokratizimit.

Mediat lokale

Në komunën e Gjakovës është 1 televizion dhe 4 radio lokale: RTV Syri, Radio Gjakovë, Radio Pandora, Top Radio dhe Radio Amadeus. TV Syri ka kontratë me Kuvendin Komunal për transmetimin e mbledhjeve të Asamblesë komunale. Ndër Radiot - Radio Gjakova ka një dëgjueshmëri të madhe dhe besim tek qytetarët, ndërsa radiot tjera kanë më shumë program argëtues, se sa informativ. Korrespondentët e gazetave kanë Shoqatën e gazetarëve të vendosur në objektin e komunës.

Rendi dhe ligji në Komunën e Gjakovës

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Gjakovës kanë ndodhur 3512 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 65 shkelje të natyrave të ndryshme. Ky numër i rasteve nuk është real, ngase Policia e Kosovës nuk ka paraqitur një statistikë për numrin e aksidenteve, e që zakonisht aksidentet përbëjnë numrin më të madh të shkeljeve të rendit dhe ligjit. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Gjakovë (2008)

Natyrë e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	-
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	166
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	35
Vjedhje e pyjeve	14
Incidente lidhur me pronën	189
Vjedhje	1039
Abuzime seksuale	11
Shkaktim të dëmtimeve trupore	180
Kërcënime	43
Mashtrime	18
Vrasje	22
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	-

Komuna e Gjakovës ndodhet në mesin e dhjetë komunave të Kosovës që kanë numrin më të madh të prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Në mesin e njëjtë Gjakova ndodhet edhe sa i përket pengimit të personave zyrtar në kryerjen e punës. Komuna e Gjakovës renditet e gjashta edhe sa i përket numrit të madh të vjedhjeve, me 1,039 raste gjatë vitit të kaluar. Bilancin më të keq Gjakova e ka për sa i përket numrit të vrasjeve me 22 sosh, duke e renditur këtë komunë në vendin e tretë, pas Prishtinës dhe Ferizajt.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përllongariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifën tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifën e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Gjakovës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.10%	0.10%	0.25%	0.20%	0.10%
I	500€*	400€	1100€	800€	-

II	400€	350€	1000€	700€	-
III	350€	300€	800€	600€	-
IV	300€	250€	600€	450€	-

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Gjakovës zhvillojnë veprimtarinë një numër i madh i bizneseve private, veprimtaria e të cilave është tregtare, shërbyese, transportuese, etj. Të gjitha bizneset janë të obliguara që për punën e tyre të bëjnë pagesën vjetore për leje të punës. Kuvendi Komunal i Gjakovës ka miratuar Rregulloren komunale për taksa, gjoba dhe ngarkesa sipas së cilës janë caktuar çmimet për çdo lloj biznesi.

Tab.9. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	350 €
Kompanitë e sigurimit	350 €
KEK	350 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	350 €
Agjensionet turistike	350 €
Hotelet	180 €
Motelet	180 €
Supermarketet-Hipermarketet	180 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	180 €
Kafeteritë	120 €
Restorant	120 €
Telekomunikimit	90 €
Depot	180 €
Autoshkollat	120 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrucktharitë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	30 €
Tregtia e jashtme	350 €
Bamatoret	120 €
Ndërmarrjet prodhuese	180 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	120- 180 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika ne lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.